
Lënda: Informacion i pjeshëm në lidhje me inspektimin e objektëve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhen kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

Objekti: **Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (Kryqëzimi i Rr Barikadave deri të Unaza e Tiranës, pranë Farmacias 10), Tiranë**

Investitori: **Bashkia Tiranë**

Vlera e Investimit: **98,099,287 leke +19,619,857 lekë shtesë kontratë për objektin**

përiudha kohore: **Nëntor 2012 deri në Dhjetor 2013**

Inspektimi është kryer: **Dhjetor 2018**

Ky objekt është zbatuar në qytetin e Tiranës në një nga segmentët kryesore të tij. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i "Rrugës së Dibrës", me "Rrugën e Barikadave" dhe përfundon në kryqëzimin e "Rrugës së Dibrës", me Unazën e Tiranës pranë zonës së Farmacias 10, me një gjatësi të përgjithshme rreth 1,3 km. Gjendja ekzistuese e rrugës në momentin e investimit ka qenë shumë e amortizuar.

Projekti ka ndërhyre në rehabilitimin e shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në rehabilitimin e plotë të shtresave të demtuara të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj (stabilizanti plus nënshtresat e tjera), në rehabilitimin e rrjetit të ujrave të bardha dhe të zeza, në rehabilitimin e tubacionit të ujit të pijshëm, me rikonstruksionin e të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza, në sistemimin e plotë të trotuareve, në rehabilitimin e rrjetit të ndricimit, në sinjalistikë rrugore, etj. Projekti zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të përgjithshëm të ketij segmenti rrugor. Punimet kanë filluar rreth muajit Nëntor të vitit 2012, e kanë përfunduar në muajin Dhjetor 2013, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Investimi është kryer në periudhe fushate zgjedhore (me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013). Afati i garancisë së punimeve për objektin ka përfunduar (afati për këtë objekt ka qenë dy vite). është kryer në favor të firmës zbatuese të punimeve edhe zhbllokimi i Garancisë së Punimeve prej 5 % të vlerës situacionit. Gjithashtu mendoj se do duhet të përmendim se zbatimi i punimeve është bërë në kushte të vështira, pasi rruga ka patur trafik të rënduar dhe bllokimi i saj është bërë me periudha të shkurtra kohore. Edhe pse objekti ka disa vite që është përfunduar cilësia e zërave kryesorë të punimeve lë për të dëshiruar. Sipas manualit të punimeve të ndërtimeve edhe pse garancia e punimeve zgjat vetëm dy vite, jetëgjatësia e ketyre investimeve do duhet të shkojë për një periudhe kohore prej 7 deri në 10 vite.

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Trupi i rrugës ka levizje (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit (kryesisht në të gjitha tubacionet e kanaleve të ujrave të bardha vihen re ulje edhe më të medha);
- Ka sipërfaqe të shtresës së asfaltit e cila ka filluar që të shkermoqet (gjë që tregon se shtresa asfaltike nuk është material cilësor dhe sipas standardeve);
- Vihen re thyerje e plasaritje të pllakave të trotuareve;
- Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare);
- Ka puseta të dëmtuara e vendosura jo në nivel të njëtrajtshëm me trupit e rrugës (me parete anësore të tyre të dëmtuar e që pothuajse të gjitha levizin e janë spostuar);
- Lidhja e trupit të rrugës me segmentët anësore të rrugëve në brendësi të zonës lë për të dëshiruar (nuk është bërë lidhje uniforme midis dy segmenteve të rrugës).

Vetëm gjatë kohëve të fundit Bashkisë Tiranë i është dashur të riinvestojë përseri për riparimin e shtresave të asfaltit në disa segmente ku uljet janë me evidente.

Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, nuk ka zbatuar detyrimet ligjore të saj duke zhbllokuar garancinë e punimeve, edhe pse në trupin e rrugës ka patur ulje të konsiderueshme. Të gjitha keto defekte të shfaqura, firma zbatuese e punimeve do duhej në mënyrë të menjëhershme të ndërhynte me fondet e veta për riparimin e menjëhershëm të tyre, pa pritur degradimin e mëtejshëm të saj, apo përfundimin e Garancisë së Punimeve të objektit (fondi garancisë së objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar). Janë raste shumë të vogla për të mos thenë asnjë rast ku Bashkia Tiranë të ketë marrë vendimarrje ndaj firmave të zbatimit investimet e të cilave kanë rezultuar me mangësi të theksuar të cilësisë së zbatimit të tyre.

Konkluzione në lidhje me objektin.

- Do duhen të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit në trupin e rrugës.*
- Të bëhet riparimi i pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to.*
- Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar të trotuareve me lidhje të njëtrajtshme të tyre me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza dhe plotësimi i tyre me kapakë metalike të pa levizshëm, e të vendosur në të njëjtën kuotë me trupin e rrugës.*

-
- *Të kryehet lidhja e njëtrajtëshme e të gjitha bashkimeve të segmenteve të rrugëve të brendshme, me trupin e rrugës kryesore.*
 - *Investimi i kryer në këtë segment rrugor për korsitë e dedikuar të bicikletave në të dy krahët e rrugës mendoj se është kryer pa një studim të mirëfilltë fizibilitetit (kam këtu parasysh se kjo është rruga kryesore për tu lidhur me QSUT, ndërkohe që gjatë gjithë ditës ky segment rrugor është pothuajse i bllokuar.*
 - *Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit do duhen të shikohen dhe kontrollohen me rigorozitet të gjitha investimet e kryera në fushata zgjedhore, pasi në shumicën e rasteve këto investime kanë rezultuar me problematika të shumta.*
 - *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e difekteve të vërejtura mendoj se zenë me shumë se 35 deri në 40 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".